



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 15 qershor 2020
Nr. ref.:RK 1576/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI56/19

Parashtrues

Xhevat Thaqi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML.nr. 70/2019, të 4 marsit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Xhevat Thaqi, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i përfaqësuar nga avokati Ylli Bokshi nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [PML. nr. 70/2019] e 4 marsit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), i cili iu kishte dorëzuar atij me datë 21 mars 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit, parashtruesit të kërkesës iu kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit [nr. 03/L-121] për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 prill 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 prill 2019, Kryetarja caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 30 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 14 gusht 2019, Gjykata njoftoi Gjykata Themelore në Pejë – Dega Deçan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të sjellin kopjen e lëndës-dosjes.
9. Më 27 gusht 2019, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë kopjen e lëndës-dosjes.
10. Më 29 prill 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Me 30 nëntor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPN.nr.78/2018] i caktoi parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, me fillim nga data e marrjes së vendimit në fjalë.
12. Më 20 dhjetor 2018, Prokuroria Themelore në Pejë ngriti Aktakuzë [PP/II.nr.2580/2018] kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit se kishte kryer veprën penale (Vjedhje e Rëndë), të paraparë me nenin 327 paragrafin 2 nën-paragrafin 2.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
13. Më 27 dhjetor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [P.nr.223/2018] ia vazhdoi parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit edhe për dy muaj të tjerë. Si arsye për vazhdimin e paraburgimit, ndër tjerash, u theksua se: *(i) ekziston dyshimi i bazuar se parashtruesi i kërkesës e ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet; (ii) pesha e veprës penale është e rëndë dhe se parashtruesi i kërkesës mund të ndikojë në rrjedhë të procedurës penale duke marrë parasysh të kaluarën e tij.* Më specifikisht, Gjykata Themelore e kishte arsyetuar vendimmarrjen e saj për vazhdim të paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës duke theksuar me sa vijon: *"[...] duke u bazuar në nenin 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), ka ardhur në përfundim se i pandehuri për shkak të peshës së veprës penale për të cilën parashihet një dënim i rëndë me gjobë dhe burgim nga 3 vjet deri në 7 vite si dhe dyshimet tjera të nxjerra nga baza e policisë ekziston rreziku se i njëjti mund të ndikoi në pengimin e rrjedhës së zhvillimit të procedurës penale apo edhe në përsëritjen e veprave të tilla".*
14. Sipas shkresave të lëndës, rezulton që Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Themelore iu kishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës personalisht në burg, me datë 28 dhjetor 2018. Tutje, sipas shkresave të lëndës, Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Themelore, në të njëjtën datë ishte dorëzuar në postë për dërgim tek përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës.
15. Më 14 janar 2019, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore [P.nr.223/2018], avokati i parashtruesit të kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit. Para kësaj të fundit, ai pretendoi se iu kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese dhe ato të parapara me KPPK dhe ligjet e tjera të Republikës së Kosovës, me propozimin që *"aktvendimi i atakuar [i Gjykatës Themelore] të anulohet dhe që të pandehurit të i ndërpritet menjëherë masa e paraburgimit".*
16. Më 21 janar 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.1.DP.nr.48/2019] e hodhi poshtë si të paafatshme ankesën e parashtruar nga avokati i parashtruesit të kërkesës me arsyetimin si në vijim:

"Siç del nga shkresat e lëndës aktvendimi [i Gjykatës Themelore] me të cilin të pandehurit [parashtruesit të kërkesës] i është vazhduar masa e paraburgimit [edhe për dy muaj] P.nr.223/2018, i datës 27.12.2018, të pandehurit i është dorëzuar me datën 28.12.2018, gjë që vërtetohet nga fletë

dërgesa për dorëzim personal me nënshkrimin e të pandehurit të vënë në të, ndërsa ankesën mbrojtësi i të pandehurit e ka paraqitur kundër aktvendimit e cila ankesë në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Deçan, është pranuar me 14.01.2019, gjë që vërtetohet nga vula e pranimi e Gjykatës.

Sipas dispozitave të nenit 189 paragrafi 3 të KPPK, ankesa kundër aktvendimit mbi caktimin apo vazhdimin e paraburgimit paraqitet brenda 24 orëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit, e cila dispozitë vlen edhe për aktvendimet kur caktohen masat tjera alternative. Ndërsa sipas dispozitës së nenit 478 paragrafi 4 të KPPK kur i pandehuri ka mbrojtës, shkresa i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit në pajtim me dispozitat e nenit 477 të këtij kodi. Në rastin e tillë afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedh nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit, në rastin konkret afati për parashtrimin e ankesës ka filluar të rrjedh nga dita [28 dhjetor 2018] kur i pandehuri Xhevat Thaqi [parashtruesi i kërkesës] e ka pranuar aktvendimin mbi vazhdimin e masës së paraburgimit.”

17. Kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të ligjit penal dhe shkelje të procedurës penale, me propozimin që Gjykata Supreme t'i ndryshojë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, dhe ta ndërpresë masën e paraburgimit ose ta zëvendësojë atë me një masë tjetër më të butë.
18. Më 4 mars 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.70/2019] e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar dhe e konfirmoi vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit dhe të asaj Themelore – duke e lënë kështu në fuqi masën e vazhdimin të paraburgimit dy (2) mujor.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me rastin e refuzimit të kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, i ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Ai po ashtu, pretendon shkelje të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës.
20. Parashtruesi i kërkesës thekson se avokati i tij e ka parashtruar ankesën brenda afatit 24 orësh duke qenë se Aktvendimin [P.nr.223/2018] e Gjykatës Themelore të 27 dhjetorit 2018 e ka pranuar më 8 janar 2019; ndërkaq, ankesën e ka dorëzuar me postë më 9 janar 2019.
21. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit me hedhjen e ankesës si të paafatshme, fare nuk është lëshuar në pretendimet e tij të bëra me ankesë. Një qasje e tillë e Gjykatës së Apelit, sipas pretendimit, është qëndrim “diskriminues, kundër kushtetues dhe joligjor.” Më tutje, ai pretendon se Gjykata e Apelit duhet të kishte parasysh që ai si i paraburgosur ka pasur mundësi të kufizuara të komunikimit dhe pamundësi të lëvizjes së lirë, dhe se “aplikimi i dispozitës nga

neni 478 paragrafi 4 të KPPK-së, në të cilën si datë e ecjes së afateve ligjore konsiderohet data e dorëzimit të vendimit tek i pandehuri, nuk mund të aplikohet dhe është diskriminuese”. Tutje, theksohet në kërkesën e dorëzuar para kësaj Gjykate se: “I pandehuri nuk është profesionist i fushës, përkatësisht jurist dhe zakonisht është njeri i pa udhëzuar dhe laik në çështjet ligjore, gjithashtu duke pas parasysh edhe afatin e shkurtër për parashtrimin e ankesës kundër Aktvendimit për vazhdimin të paraburgimit, paraqitja e ankesës nga ana e të pandehurit i cili gjendet në paraburgim është pothuajse e pamundur në 99% të rasteve.”

22. Në këtë aspekt, ai pretendon edhe shkelje të nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës, meqë, sipas tij, kur ligji është në kolizion me Kushtetutën ajo dispozitë nuk është e aplikueshme “dhe për këtë çështje është neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, e cila në Kosovë aplikohet drejtpërdrejte, në kuptim të nenit 22 të Kushtetutës”.
23. Në këtë aspekt, parashtruesi pretendon se afati për paraqitjen e mjetit juridik në rastet kur liria e lëvizjes së të pandehurit është e kufizuar, duhet të merret data e dorëzimit të Aktvendimit tek mbrojtësi i të pandehurit “në të kundërtën do të kemi cenim të parimit në qasje në drejtësi dhe cenim të parimit të barazisë së palëve në procedurë, përkatësisht shkelje të dispozitave të Kushtetutës.”
24. Për sa i takon vendimmarrjes nga ana e Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës thekson se as ajo nuk është lëshuar fare në vlerësimin e shkeljes së të drejtës së tij “në ankesë dhe qasje në drejtësi” dhe për rrjedhojë nuk i ka “vlerësuar fare raportet superiore në mes Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë, në rast të kontradiktave në mes tyre”.
25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t’i anulojë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe t’i shpallë ato si kundër-kushtetuese.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 22, 31 dhe 53 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ. Në thelb, parashtruesi i kërkesës paraqet dy pretendime për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ të cilat do të trajtohen ndaras në pjesën vijuese të këtij Aktvendimi.
28. Megjithatë, para se të përgjigjet në pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton rrethanat e rastit konkret. Siç u shpjegua në pjesën e fakteve, parashtruesi i kërkesës ishte në paraburgim që nga data 30 nëntor 2018 për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale të vjedhjes së rëndë. Më 20 dhjetor 2018, Prokuroria Themelore në Pejë kishte ngritur aktakuzë kundër

parashtruesit të kërkesës, e cila ishte konfirmuar nga Gjykata Themelore. Kjo e fundit, përmes Aktvendimit [P.nr.223/2018] të 27 dhjetorit 2018, e kishte konfirmuar dhe vazhduar paraburgimin parashtruesit të kërkesës edhe për dy muaj të tjerë, duke llogaritur nga data 30 dhjetor 2018, kur edhe skadonte kohëzgjatja e masës së paraburgimit. Kundër këtij Aktvendimi, avokati i parashtruesit kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit e cila e kishte refuzuar atë si të paafatshme – ngase afati, sipas dispozitave të lartcekura ligjore, ishte llogaritur që ka filluar të ecë nga momenti kur vendimi i është dorëzuar të pandehurit, respektivisht parashtruesit të kërkesës. Ky i fundit, lidhur me këtë aspekt, përmes avokatit të tij kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila po ashtu ishte refuzuar nga Gjykata Supreme si e pabazuar, si dhe njëkohësisht ishte konfirmuar vendimmarrja e gjykatave më të ulëta.

29. Gjykata vëren se kategoria e parë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me nenin 31 të Kushtetutës në aspekt të pretendimeve të parashtruesit për mohim të qasjes në drejtësi dhe mos arsyetim të vendimeve gjyqësore. Kategoria e dytë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me pretendimet për shkelje të nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës ngase, sipas parashtruesit, paragrafi 4 i nenit 478 të KPPK-së është dispozitë kundërkushtetuese dhe nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. Si rrjedhojë, gjykatat e rregullta nuk është dashur ta aplikojnë atë dispozitë në rastin e tij por është dashur të aplikojnë direkt Kushtetutën dhe KEDNJ-në. Në detaje, të gjitha pretendimet e parashtruesit janë reflektuar në paragrafët 17-23 të këtij Aktvendimi.
30. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

31. Gjykata, më tej, i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...

32. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml.nr.70/2019] e 4 marsit 2019 të Gjykatës Supreme dhe kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar ligjor.

(i) Pretendimet lidhur me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për qasje në drejtësi dhe mos-arsyetim të vendimeve gjyqësore

33. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë.
34. Për sa i takon shterimi të mjeteve juridike për këtë pjesë të kërkesës, Gjykata konstaton se në pajtim me nenin 47 të Ligjit, parashtuesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, në aspekt procedural dhe substancial, lidhur me pretendimet e tij për nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
35. Megjithatë, Gjykata po ashtu duhet të vlerësojë nëse kjo pjesë e kërkesës përmbush kriteret e përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

36. Gjykata rikujton pretendimin e parashtuesit të kërkesës sipas të cilit atij i është mohuar e drejta për qasje në drejtësi dhe e drejta për të pranuar vendime të arsyetuara gjyqësore, të drejta këto të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.
37. Parashtuesi i kërkesës pretendon se iu është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ngase ankesa e avokatit të tij në mënyrë të padrejtë është refuzuar si e paafatshme dhe se Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit, fare nuk ishin lëshuar në pretendimet e tij të bëra në ankesë, respektivisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe nuk kishin marrë për bazë faktin që ai ishte në paraburgim dhe mundësitë për parashtrimin e ankesës i kishte të limituara. Këto gjykata, sipas tij, nuk kishin arsyetuar çështjen e mohimit të qasjes së tij në drejtësi.
38. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi interpretimin e gabuar të paragrafit 4 të nenit 478 të KPPK-së nga ana e Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme. Për sa i takon arsyetimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata

konsideron se gjykatat e rregullta e kanë përmbushur obligimin për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor.

39. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton se pretendimet që kanë të bëjë me fushën e ligjshmërisë nuk bien nën juridiksionin e kësaj Gjykate, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35). E vetmja mënyrë se si këto pretendime do të mund të shqyrtoheshin dhe të pranoheshin si të bazuara është rasti kur një parashtrues arrin të dëshmojë, me argumente bindëse se, në rastin e tij konkret, ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së, për shembull, duke argumentuar se në rastin konkret gjykatat e rregullta i kanë zbatuar dispozitat e KPPK-së në mënyrë qartazi arbitrare.
40. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit është i qartë. Aty theksohet se afati për dorëzimin e ankesës rrjedh nga dita e dorëzimit të Aktvendimit tek i pandehuri, respektivisht parashtruesi i kërkesës dhe se Aktvendimi i Gjykatës Themelore iu kishte dorëzuar atij më 28 dhjetor 2018, gjë që, sipas Gjykatës së Apelit *“vërtetohet nga fletë dërgesa për dorëzim personal me nënshkrimin e të pandehurit të venë në të”*, ndërsa ankesën mbrojtësi i tij e kishte paraqitur me datë 14 janar 2019, që do të thotë jashtë afatit prej 24 orëve, siç përcaktohet me nenin 189 paragrafi 3 të KPPK-së. Parashtruesi i kërkesës vet, nuk kishte dorëzuar ankesë brenda afatit 24 orësh.
41. Gjykata po ashtu rikujton se Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit, duke interpretuar dispozitat e KPPK-së ashtu siç ajo e kishte konsideruar si mënyrën më të drejtë për rrethanat e rastit konkret dhe për zgjedhjet e saj kishte dhënë arsyetime të mjaftueshme. Më saktësisht për sa i takon interpretimit ligjor të dispozitave të KPPK-së, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj kishte theksuar si në vijim:

“Sipas dispozitës së nenit 189 par.3 të KPPK, secila palë mund të paraqesë ankesë brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit, e cila dispozite vlen edhe për aktvendimet me të cilat caktohet paraburgimi, ndërsa sipas dispozitës së nenit 478 par.4 të KPPK, në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës shkresat i dërgohen mbrojtësit dhe të pandehurit në pajtim me dispozitat e nenit 477 të këtij Kodit. Në rastin e tillë, afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedhë nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit.

Ligji – Kodi i Procedurës Penale në këtë dispozitë nuk bënë dallimin se i pandehuri a gjendet në paraburgim apo në liri, për çka nuk ka qenë e mundur se në këtë rast afati për ushtrimin e ankesës të llogaritet ndryshe, siç pa bazë pretendohet në kërkesë”.

42. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se edhe sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), afati për të parashtruar ankesë fillon të ecë që nga data në të cilën parashtruesit të kërkesës dhe/ose avokatit të tij i është dorëzuar vendimi (Shih, rastin e GJEDNJ-së: *Koç*

et Tosun kundër Turqisë, kërkesa nr.23852/04, Vendim i 13 nëntorit 2008, paragrafi 6).

43. Gjykata po ashtu konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar para gjykatave të rregullta, e as para kësaj Gjykate, se si ndodhja e tij në paraburgim ia ka pamundësuar ushtrimin e mjeteve juridike brenda afateve të përcaktuara ligjore. Në rast se parashtruesi i kërkesës vërtetë ka pasur pamundësi konkrete/specifike të ushtrimin të ankesës së tij si pasojë e rrethanave konkrete në të cilat është ndodhur në paraburgim, atëherë argumentet e tilla do duhej t'i paraqiste para gjykatave të rregullta ose organeve të tjera përgjegjëse për respektim të të drejtave të tij gjatë kohës kur ai mbahet në paraburgim. Me Kushtetutë, e drejta në ankesë ndaj një vendimi që vendos për ndonjë të drejtë apo liri të tij është e garantuar për secilin individ dhe në çfarëdo rrethane në të cilën ndodhet ai person, përfshirë personat që ndodhen në paraburgim. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykatës nuk i është ofruar asnjë dëshmi apo provë se e drejta e parashtruesit të kërkesës për "qasje në drejtësi" i është mohuar në çfarëdo mënyre nga gjykatat e rregullta apo nga ndonjë autoritet tjetër publik në Republikën e Kosovës.
44. Andaj, në rrethana të rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë apo KEDNJ i janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të KPPK-së. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
45. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 28).
46. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë.

47. Për sa i përket arsyetimit të vendimeve gjyqësore nga ana e gjykatave të rregullta, ajo e Apelit dhe Supreme, Gjykata konsideron se të dyja gjykatat kanë përmbushur obligimin e tyre kushtetues për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor përkitazi me kërkesat dhe pretendimet e parashtruesit. Për rrjedhojë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka përfituar nga e drejta e tij për të pranuar vendime të arsyetuara gjyqësore në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih në këtë aspekt rastet e Gjykatës Kushtetuese që flasin për arsyetim të vendimeve gjyqësore: *KI72/12, Veton Berisha dhe Ilfete Haziri, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, Naser Husaj, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI143/16, Muharrem Blaku dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; dhe KI97/16, parashtrues "IKK Classic", Aktgjykim i 9 janarit 2018).*
48. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se është "diskriminuese" llogaritja e afatit prej datës së dorëzimit të vendimit tek i pandehuri dhe se një qasje e tillë e Gjykatës së Apelit, sipas parashtruesit të kërkesës, është qëndrim "diskriminues, kundër kushtetues dhe joligjor". Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përveç që e ka cekur se është diskriminuese qasja e tillë gjykatave, ai nuk ka ofruar asnjë sqarim shtesë se si pretendon se e drejta e tij është shkelur dhe se si ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me individë të tjerë në rrethana të njëjta apo të ngjashme.
49. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kjo pjesë e kërkesës duhet të shpallet si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese sipas rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

(ii) Pretendimet lidhur me jo-kushtetutshmërinë e paragrafit 4 të nenit 478 të KPPK-së

50. Gjykata rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës sipas të cilit paragrafi 4 i nenit 478 [Shkresat që duhet dorëzuar personalisht] i KPPK-së është diskriminues dhe jokushtetues.
51. Parashtruesi i kërkesës konsideron se ky paragraf, në pjesën ku parashihet se: *"Në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës, shkresa nga paragrafi 2. i këtij neni i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit në pajtim me dispozitat e nenit 477 të këtij Kodi. Në rastin e tillë, afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedhë nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit. Kur të pandehurit nuk mund t'i dorëzohet vendimi apo ankesa për shkak të mosdhënies së adresës, ato vihen në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide"* – është diskriminues dhe jokushtetues sepse nuk duhet të konsiderohet se ecë afati i ankesës nga momenti kur një vendim i dorëzohet të pandehurit i cili është në paraburgim.
52. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit ku specifikisht parashihet që: *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara në ligj"*. Gjykata po ashtu i referohet pikës (b) të paragrafi (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës ku parashihet se: *"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme*

nëse: [...] (b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

53. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thekson se është shkelur neni 22 dhe 53 i Kushtetutës, ngase Gjykata Supreme nuk e ka marrë parasysh raportin superior të KEDNJ-së në raport me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe faktin se kur një ligj është në kolizion me Kushtetutën dhe KEDNJ-në – ajo dispozitë e ligjit nuk duhet të aplikohet.
54. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata thekson se pajtohet me konstatimin e saktë të parashtruesit të kërkesës se një ligj nuk është mbi Kushtetutën dhe KEDNJ-në dhe se këto dy instrumente kanë përparësi dhe superioritet ndaj çdo ligji. Një parim i tillë për KEDNJ-në parashihet në nenin 22 të Kushtetutës ku specifikisht thuhet: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”*
55. Megjithatë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës është dashur që pretendimet e tij për jo-kushtetutshmëri të paragrafit 4 të nenit 478 të KPPK-së t'i ngritë para gjykatave të rregullta apo që, bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës, të paraqes kërkesës për kontroll incidental të kushtetutshmërisë së asaj dispozita ligjore me Kushtetutën dhe/apo KEDNJ-në. Parashtruesi i kërkesës e ka pasur mundësinë që argumentet e tij për kolizion të pretenduar të kësaj dispozite ligjore me Kushtetutë dhe KEDNJ – t'i ngritë para Gjykatës Supreme. Ai nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe pretendimet e tij për kolizion të mundshëm dhe jokushtetutshmëri të paragrafit 4 të nenit 478 të KPPK-së – po i ngritë për herë të parë para Gjykatës Kushtetuese.
56. Gjykata thekson se gjykatat e rregullta e kanë për detyrë që kërkesat e parashtruesve për jo kushtetutshmëri të ligjit t'i shqyrtojnë dhe të vendosin se a kanë nevojë të miratohen apo jo. Në rast se edhe gjykatat e rregullta kanë dyshime për kushtetutshmërinë e një dispozite ligjore dhe konsiderojnë se nuk mund ta zbatojnë atë vet – atëherë rasti duhet të përcjellët në Gjykatën Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës. Në rast se gjykatat e rregullta konsiderojnë se argumentet e parashtruesit nuk janë të bazuara dhe se nuk ka dyshime për kushtetutshmërinë e ligjit në fjalë – i njëjti mund të vazhdojë të zbatohet. Mirëpo, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës fare nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës Supreme që të deklarohet lidhur me pretendimin për jo-kushtetutshmëri të dispozitës ligjore në fjalë, ngase këtë pretendim po e paraqet për herë të parë para kësaj Gjykate.
57. Andaj, në dritë të kësaj që u tha më lart, Gjykata konstaton që ky pretendim i parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht kjo pjesë e kërkesës duhet të refuzohet për mos-shterim substancial të të gjitha mjeteve juridike, bazuar në nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së Punës.

Përfundime

58. Përkitazi me pretendimet për shkelje të të drejtave për “qasje në drejtësi” dhe “arsyetim të vendimeve gjyqësore” të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstatoi se ajo pjesë e kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
59. Përkitazi me pretendimin për jokushtetutshmëri të paragrafit 4 të nenit 478 të KPPK-së, Gjykata konstatoi se kjo pjesë e kërkesës, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, duhet të shpallet e papranueshme për shkak të mosshterritit substancial të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47.2 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 29 prill 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi